

Eco Block

ENGINEERED FOR THE FUTURE

Fleksibilitet gipsi,
qendrueshmëri betoni

TEKNOLOGJI MODERNE NDËRTIMI
PËR PROJEKTE REZIDENCIALE,
KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE.



RRETH NESH

EcoBlock është një kompani e fokusuar në prodhimin e materialeve moderne të ndërtimit, e themeluar si fabrikë prodhimi që prej vitit 2007.

Me eksperiencë të konsoliduar në industri dhe fokus të vazhdueshëm në cilësi, efikasitet dhe inovacion, kompania ofron produkte të dizajnuara për të përmbushur standardet e ndërtimit bashkëkohor.

Çdo produkt EcoBlock është rezultat i një procesi të kontrolluar prodhimi, duke garantuar standard të lartë, qëndrueshmëri dhe konsistencë në çdo njësi. Procesi i prodhimit realizohet përmes teknologjive moderne dhe kontrollit të vazhdueshëm të parametrave teknikë, duke siguruar performancë të lartë në çdo projekt ndërtimi.



Zgjidhje moderne në beton të ajrosur

EcoBlock përfaqëson një gjeneratë të re materialesh ndërtimi që kombinon lehtësinë, rezistencën dhe izolimin në një produkt të vetëm. I projektuar për të përmbushur kërkesat e ndërtimit modern, ky material ofron performancë të lartë dhe efikasitet në çdo fazë të projektit.

Struktura e optimizuar siguron shpërndarje të njëtrajtshme të densitetit, duke rritur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e produktit.

Pesha e reduktuar kontribuon në uljen e ngarkesës mbi strukturën mbajtëse, duke ndikuar pozitivisht në projektimin konstruktiv dhe eficiencën e përgjithshme të ndërtimit.

EcoBlock është zhvilluar për një gjeneratë të re ndërtimesh që kërkojnë efikasitet energjitik, siguri strukturore dhe optimizim afatgjatë të kostove.



VLERAT KRYESORE

Një material – shumë përfitime

1. Efikasitet termik dhe komoditet

Ofron izolim termik të lartë, duke ulur nevojën për izolim shtesë. Ndhmon në ruajtjen e një mikroklimë të qëndrueshme dhe përmirëson komoditetin e brendshëm, përfshirë edhe izolimin akustik.

2. Ndërtim më i lehtë dhe më ekonomik

Pesha e lehtë redukton ngarkesën në strukturë, ndërsa aplikimi ergonomik dhe saktësia dimensionale mundësojnë ndërtim më të shpejtë. Përdorimi i kollës në vend të llaçit kursen material, kohë dhe kosto pune.

3. Siguri dhe stabilitet

Ka rezistencë të lartë në shtypje, është rezistent ndaj temeteve dhe ofron mbrojtje ndaj zjarrit deri në 6 orë. Kjo e bën produktin të qëndrueshëm dhe të sigurt për përdorim afatgjatë.

4. Qasje ekologjike dhe e qëndrueshme

EcoBlock është pjesë e një qasjeje moderne ndërtimi që synon reduktimin e ndikimit në mjedis. Struktura e materialit kontribuon në eficiencë më të lartë energjitike të ndërtesës, duke ndihmuar në uljen e konsumit të energjisë gjatë gjithë ciklit të përdorimit. Procesi i ndërtimit gjeneron më pak mbetje në kantier dhe mundëson përdorim më racional të materialeve ndërtimore. Zgjidhja është e orientuar drejt ndërtimeve të qëndrueshme, me fokus në performancë afatgjatë dhe standarde bashkëkohore ekologjike.



PSE PREFEROHET NGA INVESTITORËT

Efikasitet për investitorin dhe ndërtimin

EcoBlock është zgjedhje strategjike për investitorë dhe kompani ndërtimi që kërkojnë optimizim të kostove dhe performancë më të lartë të projektit.

Përfitimet kryesore:

- Redukton kostot e ndërtimit
- Përshpejton afatet e ndërtimit
- Ul ngarkesën mbi strukturën mbajtëse
- Përmirëson performancën energjitike të objektit
- Rrit cilësinë finale të ndërtimit
- Redukton kostot operative afatgjata
- Optimizon procesin e ndërtimit në çdo fazë



Pse EcoBlock është zgjedhja më e mirë?

Ndërtimi me EcoBlock ofron përfitime të dukshme në krahasim me produktet qeramike, duke përmirësuar cilësinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e ndërtimit.

SUPERIOR NDAJ PRODUKTEVE QERAMIKE

EcoBlock
ENGINEERED FOR THE FUTURE



Pesha	<input checked="" type="checkbox"/> E lehtë	E rëndë
Izolim termik	<input checked="" type="checkbox"/> I lartë	I ulët
Nevojë për izolim	<input checked="" type="checkbox"/> Jo	Po
Shpejtësia e ndërtimit	<input checked="" type="checkbox"/> E lartë	E ulët
Material lidhës	<input checked="" type="checkbox"/> Kollë (minimal)	Llaç (i lartë)
Izolim akustik	<input checked="" type="checkbox"/> I lartë	Mesatar
Rezistenca në shtypje	<input checked="" type="checkbox"/> E lartë	Më e ulët
Ngarkesa në strukturë	<input checked="" type="checkbox"/> E ulët	E lartë

SIGURIA NDAJ ZJARRIT

Siguri maksimale ndaj zjarrit

EcoBlock është projektuar për të ofruar mbrojtje të lartë në situata zjarri. Falë strukturës minerale, materiali ruan stabilitetin në temperatura të larta, pengon përhapjen e flakës dhe nuk çliron substanca të dëmshme.

Pikat kryesore:

- Rezistencë e lartë ndaj zjarrit
- Pengon përhapjen e flakës
- Nuk çliron gazra toksikë
- Ruan stabilitetin në temperatura të larta
- Rrit sigurinë e ndërtesës dhe të përdoruesve



Siguria ndaj zjarrit nuk është opion — është domosdoshmëri.

Eco Block
ENGINEERED FOR THE FUTURE

APLIKIMI NË NDËRTIM

I përshtatshëm për çdo projekt

EcoBlock mund të përdoret në një gamë të gjerë aplikimesh ndërtimi, duke ofruar fleksibilitet dhe efikasitet në çdo projekt.

Aplikimet:

- Mure të jashtme
- Mure të brendshme
- Projekte banimi
- Vila dhe apartamente
- Ndërtime komerciale
- Veshje termoizoluese në ndërtimet pa Ecoblock
- Objekte industriale

Sistemi i ndërtimit me kollë mundëson saktësi më të lartë dhe reduktim të materialeve ndihmëse, duke përmirësuar cilësinë dhe shpejtësinë e ndërtimit.





EFIKASITETI EKONOMIK

Efikasitet ekonomik në çdo projekt

EcoBlock nuk është vetëm një material ndërtimi, por një zgjidhje që optimizon kostot totale të projektit.

Përfitimet ekonomike:

- Eliminon nevojën për izolim termik
- Redukton kohën e ndërtimit
- Kërkon më pak fuqi punëtore
- Konsum minimal të materialeve lidhëse
- Redukton kostot operative afatgjata
- Përmirëson eficiencën energjitike të ndërtesës

SPECIFIKIME TEKNIKE

Informacione teknike

Normativa

Përmasat	m3 / Paletë	Copë / m3	Copë / Paletë	Copë / m2	m2 / m3m	2 / Paletë
600×250×80 cm	1.44	83	120	6.5	12.45	18.0
600×250×100 cm	1.44	67	96	6.5	10.05	14.4
600×250×120 cm	1.44	56	80	6.5	8.4	12.0
600×250×150 cm	1.44	45	64	6.5	6.75	9.6
600×250×180 cm	1.51	37	56	6.5	5.55	8.4
600×250×200 cm	1.44	33	48	6.5	4.95	7.2
600×250×200 cm	1.5	27	40	6.5	4.05	6.0

Specifikime teknike

Përmasat	Pesha / m3 (kg)	Pesha / copë (kg)	Fortësia në shtypje (N/mm2)	Përcjellshmëria termike (λ)	Kapaciteti termik (E+6J/m3K)	Indeksi i izolimit akustik (dB)	Indeksi i absorbimit akustik
600×250×80 cm	540 - 580	6.5 - 7	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	30 - 32	≥ 0.3
600×250×100 cm	540 - 581	8 - 8.6	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	33 - 35	≥ 0.3
600×250×120 cm	540 - 582	9.6 - 10.3	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	36 - 38	≥ 0.3
600×250×150 cm	540 - 583	12 - 12.9	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	40 - 42	≥ 0.4
600×250×180 cm	540 - 584	14.6 - 15.6	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	42 - 45	≥ 0.5
600×250×200 cm	540 - 585	16.4 - 17.6	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	45 - 48	≥ 0.5
600×250×200 cm	540 - 586	20 - 21.5	2 ± 0.2	0.13 ± 0.02	0.54 ± 0.1	48 - 50	≥ 0.5

CILËSI & STANDARDE

Cilësi e kontrolluar për performancë afatgjatë

EcoBlock prodhohet sipas proceseve të kontrolluara teknike, duke garantuar uniformitet, saktësi dimensionale dhe performancë të qëndrueshme. Produktet janë të dizajnuara për të përmbushur kërkesat moderne të ndërtimit dhe standardet bashkëkohore të cilësisë dhe sigurisë.

Kualiteti dhe shërbimi

Produktet Ecoblock janë të prodhuara në pajtueshmëri me parimet rigoroze dhe që plotësojnë standardet e larta të kualitetit DIN, EN.

EN 1745:2002 (Rezistenca në shtypje)
A DIN 4102 & EN 771-2 (Zjarrdurueshmeria)





Teknologji moderne për një standard të ri ndërtimi.

NDËRTO MË LEHTË.
NDËRTO MË SHPEJT.
NDËRTO MË ZGJUAR.



MË SKANO

☎ 068 20 94 094 | 068 90 30 769

📍 Rruga " Fabrika e Qelqit", Tiranë

✉ info@ecoblock.al

🌐 ecoblock.al